



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 61

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS NË MINISTRINË E KULTURËS, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 22 Shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrativ me:

SUBJEKT: Zj. Zerina Bruci, person përgjegjës i ngarkuar nga ligji për raportimin e veprimtarive, për Ministrinë e Kulturës

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj Ministrisë së Kulturës, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 23.1.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike të kryer nga Ministria Kulturës, e cila rezultojn e paraportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

" Ministria e Kulturës Elva Margariti dhe ajo e Mjedisit dhe Turizmit, Mirela Kumbaro po bëjnë bilancin e vitit të kaluar, ndërsa prezantuan dhe pritshmëritë e tyre për këtë vit që sapo ka nisur."

Link:<https://www.oranews.tv/vendi/turizmi-dhe-kultura-ne-site-kumbaro-80-milione-dollar-per-te-pastruar-vjo-i1071654>

Bazuar në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht denoncimin, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 16.02.2023, Ministrisë së Kulturës i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 22.02.2023, Ministria e Kulturës bën me dije se: *"Në lidhje me aktivitetin e Ministrisë së Kulturës në sallën COD në Kryeministri, ju informojme se: Aktiviteti "Ministria e Kulturës 2022", zhvilluar më datë 18.1.2023, ora 11:00, salla COD, Kryeministri, është një takim raportues për arritjet e vitit 2022 dhe për objektivat e prioritetet e punës së Ministrisë së Kulturës për vitin 2023. Për këtë arsye dhe temë, ky aktivitet ka pasur prezent nivelin e lartë drejtues të Ministrisë së Kulturës (Minister, zvendësministër, sekretari i përgjithshëm dhe drejtorë të përgjithshëm) si dhe krerët e disa prej institucioneve vendore në varësi të ministrisë. Aktiviteti i mësipërm është raportuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me 17.1.2023".*

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se veprimtaria publike e zhvilluar nga Ministria e Kulturës, nuk përbën shkelje sipas parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator pasi veprimtaria rezulton të jetë raportuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 17.1.2023.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S :

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 61
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të Ministrisë së Kulturës, për raportimin e veprimtarive publike"

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Zerina Bruci, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Ministrinë e Kulturës.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI